Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rexha shpk" të datës 12.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe Renovimi i Lodrave në Kryeqytet - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-26-7402-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rexha shpk" të datës 12.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe Renovimi i Lodrave në Kryeqytet - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-26-7402-2-1-1.

II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rexha shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 12.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe Renovimi i Lodrave në Kryeqytet - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-26-7402-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

1. Kamioni kiper me kran me peshë bartëse 7–9 t (Aneksi 8, nr. 5)
Intervali vendos njëkohësisht kufi minimal dhe maksimal. Përjashtohen edhe mjetet më të vogla, edhe ato më të mëdha, pa e lidhur këtë me ndonjë ngarkesë konkrete. Paramasa nuk jep peshën e asnjë elementi. Elementet e parashikuara janë kryesisht lodra të prodhuara industrialisht (poz. 6–23), mobilie urbane (poz. 24–25), skajore dhe kubëza (poz. 5), materiale të shkrifëta për shtresa 10 cm (poz. 3–4) dhe shtylla Ř125 mm (poz. 27). Asnjëri prej tyre nuk dëshmon nevojën për minimum 7 t peshë bartëse, as arsyen pse një kamion mbi 9 t do të ishte i papërshtatshëm.
Pesha bartëse, kapaciteti ngritës i kranit dhe përmasat e mjetit janë karakteristika të ndryshme. Nëse qëllimi është ngritja e elementeve, kriteri duhet të lidhet me peshën e tyre dhe me kapacitetin e kranit në rrezen e punës. Nëse qëllimi është qasja në kënde lodrash me hapësirë të kufizuar, ai duhet të lidhet me përmasat e mjetit dhe me kushtet e qasjes. Dosja nuk shpjegon pse kërkohet minimumi 7 t, as pse një kamion me peshë bartëse rreth 5 t nuk do t'i kryente transportet kur ngarkesat dhe organizimi i punës e lejojnë. Kerkohet:Të hiqet intervali i mbyllur 7–9 t dhe të zëvendësohet me kërkesë funksionale

2. Dy eskavatorët, intervalet e tonazhit dhe kufizimi në zinxhirë gome (Aneksi 8, nr. 1 dhe 2) *Aneksi 8 kërkon një "eskavator me zinxhir gome me kapacitet 9–10 tonë" dhe një "eskavator me kapacitet 3–4 tonë". Paramasa nuk ka asnjë pozicion gërmimi. Hapjet e vetme që nënkuptohen janë bazamentet e poz. 27 (rreth 0,8 mł për shtyllë) dhe të poz. 28 (rreth 0,075 mł, ose gotë e parafabrikuar). Këto vëllime nuk e arsyetojnë nevojën për dy eskavatorë të klasave të ndryshme, përdorimin e tyre njëkohësisht apo kufijtë e saktë të tonazhit.*
• Dosja nuk jep thellësi gërmimi, kërkesa produktiviteti, kufizime terreni apo përmasa të hapësirave të punës që do ta shpjegonin përjashtimin e pajisjeve jashtë intervaleve 9–10 t dhe 3–4 t.
• Nuk shpjegohet pse eskavatori duhet të jetë domosdoshmërisht me zinxhirë gome dhe pse nuk lejohet eskavatori me rrota gome. Nëse synohet mbrojtja e sipërfaqeve ekzistuese, AK duhet të shpjegojë pse ky rezultat nuk arrihet edhe me rrota gome dhe me masa mbrojtëse. Nëse synohet stabiliteti ose lëvizja në terren të vështirë, duhet të identifikohen lokacionet dhe karakteristikat që e bëjnë këtë të domosdoshme.
• Vetë dosja nuk e kufizon sistemin e lëvizjes për eskavatorin 3–4 t. Kjo tregon se mënyra e lëvizjes nuk është trajtuar si kusht thelbësor për punët në këndet e lodrave. Kerkohet :Të hiqet detyrimi për dy eskavatorë me këto intervale dhe kriteri të riformulohet sipas punëve konkrete, p.sh. "një eskavator i përshtatshëm për hapjen e bazamenteve të paramasës".

3.Ngarkuesi me pirun dhe kovë "me kapacitet 2–3 tonë" (Aneksi 8, nr. 3)
Formulimi nuk sqaron nëse "kapaciteti" është peshë operative apo kapacitet ngritës. Kjo paqartësi lejon interpretime të ndryshme gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me detyrimin e nenit 51, paragrafi 1, që kriteret të specifikohen plotësisht. Nuk identifikohen ngarkesat që e kërkojnë këtë interval, as arsyeja pse piruni dhe

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

kova duhet të jenë domosdoshmërisht në një pajisje të vetme. Kerkohet:Të saktësohet karakteristika e kërkuar, të hiqet intervali i pambështetur dhe të lejohen pajisje të kombinuara ose të ndara që i kryejnë këto funksione në mënyrë të sigurt.

4. Kompresori, gjeneratori dhe pajisja goditëse me derivate (Aneksi 8, nr. 6, 7 dhe 8)
Paramasa parashikon ngjyrosje me kompresor (poz. 20), prandaj funksioni i kompresorit nuk kundërshtohet. Kundërshtohen vlerat e sakta "10 bar – 7.5 kW" dhe "10 kW", të cilat nuk lidhen me prurjen e ajrit, me pajisjet që furnizohen apo me ngarkesën elektrike të punëve. Për pajisjen goditëse "me derivate" paramasa nuk ka pozicion prishjeje apo shpimi që e bën të domosdoshëm pikërisht këtë burim energjie. Për më tepër, vetë lista kërkon kompresor dhe gjenerator, me të cilët mund të punojnë edhe pajisje goditëse pneumatike ose elektrike. Kerkohet: Të riformulohen këto kritere sipas performancës së nevojshme, duke lejuar kapacitete dhe burime alternative energjie kur sigurojnë realizimin e punëve.

5.Personi i certifikuar për sistemet e drenazhimit (Kërkesa 2, pika 2.4)
• Paramasa nuk ka rrjete drenazhimi, tubacione drenazhuese, puseta apo kanale. Fjala "drenazhim" shfaqet vetëm në poz. 25, te ena e brendshme e koshit të mbeturinave, që ka fund të shpuar për kullimin e ujërave të shiut.
• Shtrimi i zhavorrit, zallit dhe materialeve sipërfaqësore nuk dëshmon ekzistencën e një sistemi drenazhimi që kërkon specializim. Kerkohet: Te hiqet si kerkese

6. Certifikimi ISO 3834-2:2021 (Kërkesa 4)
Paramasa përmban saldim në poz. 36, 26 dhe 27. Prandaj nuk kundërshtohet që saldimet të kryhen nga personel i kualifikuar dhe t'u nënshtrohen kontrolleve të përshtatshme.
Standardi ISO 3834 ka tri nivele: pjesa 2 – kërkesa gjithëpërfshirëse të cilësisë, pjesa 3 – kërkesa standarde dhe pjesa 4 – kërkesa elementare. AK ka zgjedhur nivelin më të lartë pa e lidhur këtë zgjedhje me kompleksitetin e nyjeve, materialet, proceset, rrezikun apo kontrollet e nevojshme.
Për poz. 36, vetë paramasa e vendos kërkesën te salduesi ("salduesit të jenë të certifikuar … sipas ISO standardeve"). Edhe pika 2.6 e Kërkesës 2 kërkon "person të trajnuar për saldim, i certifikuar". Nevoja për cilësi në saldim mbulohet, pra, në nivel të personelit.
Lodrat e reja (Kategoria B) kërkohen si produkte industriale të certifikuara. Saldimi gjatë prodhimit të tyre është përgjegjësi e prodhuesit. Kontraktuesi kryen montim, riparime dhe ndërhyrje lokale.
Certifikimi i kompanisë dhe kualifikimi i salduesit kanë funksione të ndryshme. Pretendimi ynë nuk i barazon ato. Ai mbështetet në faktin që dosja nuk shpjegon pse punët konkrete kërkojnë pikërisht certifikim gjithëpërfshirës të kompanisë.
Kerkohet:Të hiqet ISO 3834-2:2021 si kusht i përgjithshëm kualifikimi

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin profesional, pajisjet dhe certifikimet ISO janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net